

Bordi i Kompanisë së Sigurimeve "ELSIG" sha bazuar ne neni 38 të Statutit të Kompanisë, nenin 30 dhe 28 pika 2.5 të Ligjit për Sigurime nr. 05/L-045, rregulloreve të BQK-së si dhe rekomandimeve nga departamenti i ankesave ne BQK me date 31.07.2025 pas rishikimit te kushteve të pergjithshme te pasurise/prones në KS "ELSIG" miraton aneksin 1

Aneksi. 1

VETËMBAJTJA / FRANCHIZA DHE ZBRITJA E PRIMIT PËR VETËMBAJTJEN

Rëndësia dhe llojet:

Vetëmbajtja / franchiza është pjesa e shumës së dëmshpërblimit që duhet të mbulojë vetë i siguruari në rast dëmi. Ky rregullim ndihmon në mbajtjen e ulët të primeve të sigurimit dhe motivon të siguruarit që të kenë kujdes më të madh për objektet e siguruara. Shuma e Vetëmbajtja / franchiza ndryshon në varësi të llojit të sigurimit dhe kushteve të kontratës dhe mund të jetë e caktuar si një shumë fikse apo si një përqindje e dëmit apo shumës së sigurimit.

Llojet e Vetëmbajtjeve / franchizave

Ekzistojnë disa lloje të Vetëmbajtjeve / franchizave që ndryshojnë sipas llojit të sigurimit:

1. Vetëmbajtja / franchiza fikse: Një shumë fikse parash, që duhet të mbulojë i siguruari në rast dëmi (p.sh. 100 euro).
2. Vetëmbajtja / franchiza si përqindje: Një përqindje e shumës së dëmit ose e shumes se sigurimit është caktuar si Vetëmbajtje / franchize (p.sh. 10% e shumës së dëmit ose e shumës së sigurimit).
3. Kombinimi i Vetëmbajtjes / franchizës fikse dhe përqindje: Një kombinim, p.sh. 10% Vetëmbajtja / franchiza , fikse 500 euro.
4. Vetëmbajtja / franchiza e kufizuar për risk: Një Vetëmbajtje / franchizë e cila vlen vetëm për një risk të caktuar (p.sh 5% shumëse se sigurimit për atë risk – Tërmeti).

Shembuj të Llojeve të Vetëmbajtjeve / Franchizave

Lloji i Franchizës	Përshkrimi	Shembulli	Përllogaritja	Pagesa nga Siguruesi
1. Franchiza Fikse	Shumë fikse që i siguruari mban në çdo dëm.	Dëmi=500€, Franchiza = 100 €	500 € - 100 €	400 €
2. Franchiza si Përqindje (e dëmit)	Përqindje e dëmit, p.sh. 10%.	Dëmi = 1,000 €, Franchiza = 10%	1,000 € - (1,000 € × 10%) = 1,000 € - 100 €	900 €
2.1 Franchiza si Përqindje (e shumës së sigurimit)	Përqindje e shumës së	Shuma sigurimi = 100,000 €	25,000 € - (100,000 € × 10%) = 25,000 € - 10,000 €	15,000 €

	sigurimit, p.sh. 10%.	Franshiza = 10%, Dëmi = 25,000 €		
3. Franshiza e kombinuar (fikse dhe përqindje)	Kombinim i franshizës fikse dhe përqindjes.	Dëmi = 3,000 €, Franshiza Fikse = 500 €, 10% e Dëmit = 300 €	3,000 € - max(500 €, 300 €) = 3,000 € - 500 € Aplikohet vlera me e madhe	2,500 €
4. Franshiza e kufizuar për risk	Përqindje e shumës së sigurimit, p.sh. 5%.(psh tërmeti)	Shuma sigurimi per risk = 100,000 €, Franshiza = 5%, Dëmi = 25,000 €	25,000 € - (100,000 € × 5%) = 25,000 € - 5,000 €	20,000 €

Kryetari i Bordit të Drejtorëve
Agim Elshani

